



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2021 – Numri: 67

Tiranë – E mërkurë, 5 maj 2021

PËRMBAJTJA

		Faqe
Urdhër i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 183/2, datë 22.4.2021	Për një ndryshim në urdhrin nr. 633, datë 17.11.2020, “Për ndalimin e grumbullimeve në vende të mbyllura apo të hapura”, të ndryshuar.....	6689
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 18, datë 30.3.2021	Me objekt shfuqizimin e vendimit nr. 486 (86-2020-556), datë 3.3.2020, të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Kthimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë.....	6689
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 19, datë 1.4.2021	Me objekt shfuqizimin e vendimeve nr. 5545, datë 6.5.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr. 88, datë 19.2.2015, të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 00-2017-2314 (155), datë 23.11.2017, të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Pezullimin e zbatimit të vendimeve nr. 88, datë 19.2.2015, të Gjykatës së Apelit Tiranë, dhe nr. 00-2017-2314 (155), datë 23.11.2017, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.....	6696
Vendim i Autoritetit të Mediave Audiovizive nr. 64, datë 27.4.2021	Për një shtesë në vendimin e Autoritetit të Mediave Audiovizive nr. 220, datë 1.12.2017, “Mbi përcaktimin e pagesave për licencë/autorizim dhe shërbimet që kryhen nga Autoriteti i Mediave Audiovizive”.....	6704
Kërkesë e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 11/7, datë 28.4.2021	Për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Për ndërtimin e banesave për strehim social, Roskovec”.....	6704
Kërkesë e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 113/2, datë 29.4.2021	Për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Ndërtimi i godinës qendrore administrative të shërbimeve të qëndëruara të transportit rrugor shqiptar dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor”.....	6705



URDHËR

Nr. 183/2, datë 22.4.2021

PËR NJË NDRYSHIM NË URDHRIN NR. 633, DATË 17.11.2020, “PËR NDALIMIN E GRUMBULLIMEVE NË VENDE TË MBYLLURA APO TË HAPURA”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 7, pika 4, të ligjit nr. 15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, të udhëzimeve të Institutit të Shëndetit Publik, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19, si edhe vendimit të Komitetit Teknik nr. 1594/6, datë 19.4.2021,

URDHËROJ:

Në urdhrin nr. 633, datë 17.11.2020, “Për ndalimin e grumbullimeve në vende të mbyllura apo të hapura”, të ndryshuar, bëhet ndryshimi si vijon:

1. Në pikën 1 të urdhrit, togfjalëshi “deri në datën 22.4.2021” zëvendësohet me togfjalëshin “deri në datën 6.5.2021”.

2. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu

VENDIM

Nr. 18, datë 30.3.2021

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vitore Tusha	kryetare e Gjykatës Kushtetuese		
Elsa Toska	anëtare e	“	“
Marsida Xhaferllari	anëtare e	“	“
Altin Binaj	anëtar i	“	“
Përparim Kalo	anëtar i	“	“
Sonila Bejtj	anëtare e	“	“
Fiona Papajorgji	anëtare e	“	“

me sekretare Enina Kotoni, në datën 30.3.2021, mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë

dokumentesh çështjen nr. 4 (S) 2020 të Regjistrat Themeltar, që u përket:

KËRKUESE: Shoqëria “MC Networking” sh.p.k.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Drejtoria Rajonale Tatimore, Tiranë, Drejtoria e Apelit Tatimor

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 486 (86-2020-556), datë 3.3.2020, të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, si i papajtuësëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Kthimi i çështjes për rishqyrtim në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 16, pika 2, 17, 41, 42, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ); neni 1 i protokollit nr. 1 të saj; nenet 49, 50, 70 dhe 71 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Fiona Papajorgji, shqyrtoi parashtrimet e kërkuësës, e cila kërkoj pranimin e kërkesës, parashtrimet e subjekteve të interesuara, Drejtorisë Rajonale Tatimore, Tiranë dhe Drejtorisë së Apelit Tatimor, të cilat kërkuan rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuësja “MC Networking” sh.p.k. është shoqëri tregtare me seli në Tiranë, me objekt të veprimtarisë së saj tregtinë me shumicë dhe pakicë të kompjuterëve, aksesoreve të ndryshëm kompjuterikë, aksesoreve të ndryshëm elektronikë, të informatikës, shërbime interneti dhe të tjera të ngjashme.

2. Inspektorët e Drejtorisë së Verifikimit në Terren pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore në datën 6.11.2015 kanë ushtruar kontroll në vendin e veprimtarisë së shoqërisë. Ky kontroll është dokumentuar me aktkonstatimet e mbajtura për këtë qëllim, të cilat i janë dërguar Drejtorisë



Rajonale Tatimore, Tiranë për ndjekje të mëtejshme.

3. Drejtoria Rajonale Tatimore, Tiranë, me aktin nr. 78611/2 prot., datë 17.12.2015, “Njoftim vlerësimi për detyrimet tatimore”, ka njoftuar shoqërinë për pagimin e detyrimit, gjobë në masën 500.000 lekë për punonjës të padeklaruar nga subjekti tatimor.

4. Gjatë kësaj periudhe, Gjykata Kushtetuese (Gjykata) kishte filluar shqyrtimin e pajtueshmërisë me Kushtetutën të neneve 5, 7, 11, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19 dhe 20 të ligjit nr. 99/2015, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008, ‘Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë’, të ndryshuar” (ligji nr. 99/2015). Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, gjatë shqyrtimit kushtetues, në datën 23.12.2015, ka vendosur pezullimin e zbatimit të ligjit nr. 99/2015 deri në dhënien e vendimit përfundimtar prej saj. Ministria e Financave, si subjekt i interesuar në atë gjykim kushtetues, është njoftuar me shkrim në datën 24.12.2015 për pezullimin e zbatimit të ligjit.

5. Kërkuesja në datën 15.1.2016 ka paraqitur ankim në Drejtorinë e Apelit Tatimor, e cila, me vendimin nr. 11681/1, datë 29.2.2016, ka vendosur lënien në fuqi të aktit administrativ nr. 78611/2 prot., datë 17.12.2015 “Njoftim vlerësimi për detyrimet tatimore” të Drejtorisë Rajonale Tatimore, Tiranë, edhe pse në atë kohë ligjit nr. 99/2015 ishte pezulluar.

6. Në këto kushte, kërkuesja i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me kërkesëpadi me objekt shfuqizimin e njoftimit të vlerësimit nr. 78611/2 prot., datë 17.12.2015 të Drejtorisë Rajonale Tatimore, Tiranë dhe të vendimit nr. 11681/1, datë 29.1.2016 të Drejtorisë së Apelit Tatimor.

7. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 2450 (80-2016-2476), datë 18.5.2016, ka vendosur pranimin e kërkesëpadi për shfuqizimin e akteve administrative të kundërshtuara, të njoftimit të vlerësimit të Drejtorisë Rajonale Tatimore, Tiranë, si dhe të vendimit të Drejtorisë së Apelit Tatimor. Detyrimin e Drejtorisë Rajonale Tatimore, Tiranë t’i kthejë kërkueses shumën prej 500.000 lekësh.

8. Kundër këtij vendimi në datën 16.6.2016 Drejtoria Rajonale Tatimore, Tiranë ka paraqitur ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.

9. Ndërkohë, Gjykata Kushtetuese, me vendimin nr. 33, datë 8.6.2016, ka vendosur shfuqizimin si të pajtueshme me Kushtetutën të neneve 5, 14, 15, 16 (pika 4 e shtuar në nenin 121), 17, pikat 1 dhe 2, 18 (pika 2 e nenit 124) dhe 20 të ligjit nr. 99/2015. Vendimi është botuar në Fletoren Zyrtare në datën 16.6.2016 dhe ka hyrë në fuqi po atë ditë.

10. Pas dhënies së vendimit të lartpërmendur nga Gjykata Kushtetuese, Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 486 (86-2020-556), datë 3.3.2020, ka vendosur: “Ndryshimin e vendimit nr. 2450 (80-2016-2476), datë 18.5.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Rrëzimin e padisë së palës paditëse, shoqëria “MC Networking” sh.p.k.”.

11. Në datën 2.7.2020 kërkuesja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese me kërkesë për shfuqizimin e vendimit nr. 486 (86-2020-556), datë 3.3.2020, të Gjykatës Administrative të Apelit. Kolegji i Gjykatës Kushtetuese në datën 18.9.2020, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë dokumentesh.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

12. Kërkuesja ka parashtruar, në mënyrë të përmbledhur, se i është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor, e parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së dhe e drejta e pronës, e garantuar nga neni 41 i Kushtetutës dhe neni 1 i Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së. Më konkretisht ajo ka argumentuar se vendimi gjyqësor i kundërshtuar cenon:

12.1 *Parimin e sigurisë juridike*, pasi në kundërshtim me nenet 132, pika 1 dhe 145, pika 2, të Kushtetutës, Gjykata Administrative e Apelit nuk ka zbatuar vendimin nr. 33, datë 8.6.2016 të Gjykatës Kushtetuese.

12.2 *Standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi Gjykata Administrative e Apelit gjatë arsytimit të vendimit nuk ka marrë parasysh vendimin nr. 33, datë 8.6.2016, të Gjykatës Kushtetuese për shfuqizimin e nenit 14 të ligjit nr. 99/2015, i cili kishte ndryshuar nenin 119 të ligjit nr. 9920/2008, që ishte baza ligjore e vendosjes së masës së gjobës ndaj kërkueses, edhe pse kjo rrethanë ishte parashtruar në shpjegimet shtesë të depozituara nga kërkuesja. Në këtë mënyrë, Gjykata Administrative



e Apelit ka mohuar dhënien e drejtësisë. Gjithashtu, vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit është kontradiktor, pasi pjesa arsyetuese e vendimit, në të cilën gjykata argumenton se ndaj tij nuk mund të ushtrohet rekurs, nuk përputhet me pjesën urdhëruese, ku lexohet se ndaj vendimit mund të ushtrohet rekurs.

13. **Subjekti i interesuar, Drejtoria Rajonale Tatimore, Tiranë** ka paraqitur parashtrime me shkrim, duke argumentuar:

13.1 Kërkesa duhet të rrëzohet si e pambështetur në ligj, në fakte dhe prova ose duhet të nxirret jashtë juridiksionit të Gjykatës Kushtetuese, pasi kërkuuesja nuk ka shteruar mjetet juridike, sepse nuk ka ushtruar rekurs brenda afateve të përcaktuara nga ligji.

13.2 Inspektorët e verifikimit të terrenit i kanë përmbushur detyrat e tyre dhe shënimi gabimisht i adresës së kërkueses nuk i heq fuqinë provuese aktit të konstatimit. Aktkonstatimi është i datës 6.11.2015 dhe është provuar që është mbajtur në vendin e kontrollit, sipas adresës së caktuar në ekstraktin historik të shoqërisë. Pretendimi i kërkueses se punonjësi i konstatuar si i padeklaruar, në fakt ishte punonjës në një kompani tjetër dhe bashkëpunonte me kërkuesen, është shqyrtuar hollësisht nga gjykata.

13.3 Pretendimi i kërkueses për cenimin e *standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor* është i pabazuar në ligj dhe në prova. Gjykata ka analizuar plotësisht kërkimet e paditëses, duke arritur në konkluzionin e drejtë se vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë Administrative duhej të ndryshohej dhe padia të rrëzohej.

13.4 Gjykata Administrative e Apelit e ka shqyrtuar ankimin mbi bazë dokumentesh në dhomë këshillimi, duke u bazuar në pretendimet e palëve dhe në provat shkresore që ekzistonin në kohën e kryerjes së veprimit konkret administrativ, për të cilin momenti i konstatimit është i datës 6.11.2015, ndërsa njoftimi i vlerësimit është i datës 17.12.2015.

14. **Subjekti i interesuar, Drejtoria e Apelit Tatimor,** ka paraqitur parashtrime me shkrim, duke argumentuar:

14.1 Pretendimi se gjoba duhet të shfuqizohet, pasi vendimi i Gjykatës Kushtetuese që shfuqizon një ligj i shtrin efektet edhe për çështjet që nuk kanë marrë formë të prerë, është i pabazuar.

14.2 Ligji nr. 99/2015 ka hyrë në fuqi në datën 12.11.2015, ndërsa shkelja është konstatuar në datën 6.11.2015, pra para hyrjes në fuqi të ligjit dhe dënimi i zbatuar për shkeljen është në masën 500.000 lekë, sipas dispozitës që ka qenë në fuqi në momentin e konstatimit të shkeljes.

14.3 Shfuqizimi i një ligji nga Gjykata Kushtetuese nënkupton zbatimin e dispozitës së mëparshme dhe jo moszbatimin e asnjë dispozite, për pasojë krijimin e një vakumi ligjor në veprimtarinë administrative.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

15. Gjykata Kushtetuese vë në dukje, se prej datës 23.3.2018 nuk ka pasur kuorumin e nevojshëm ligjor, të parashikuar nga neni 32, pika 1, i ligjit nr. 8577/2000, për shqyrtimin e çështjeve në seancë plenare. Pas plotësimit të këtij kuorumi u bë e mundur marrja në shqyrtim e çështjes konkrete.

A. Për legjitimitimin e kërkueses

16. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhen me inicimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134 pika 1, shkronja “I” dhe pika 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë.

17. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

18. Gjykata vlerëson se kërkuuesja, si person juridik, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I” dhe pika 2, të Kushtetutës, sepse ka qenë palë në procesin gjyqësor, në të cilin është dhënë vendimi që kundërshtohet në Gjykatën Kushtetuese.



19. Për sa i takon *shterimit të mjeteve juridike*, Gjykata, në praktikën e saj, ka pranuar se në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “P”, të Kushtetutës, shterimi i mjeteve juridike nënkupton që ankuesi duhet të shfrytëzojë, në shkallët e sistemit gjyqësor, të gjitha mjetet e lejueshme dhe mundësitë procedurale për vendosjen në vend të të drejtave të pretenduara të shkelura. Mjetet ligjore shterojnë kur, në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi (*shih vendimin nr. 56, datë 25.7.2017, të Gjykatës Kushtetuese*). Në çështjen konkrete, vendimi i fundit është dhënë nga Gjykata Administrative e Apelit, i cili, bazuar në nenin 56, të ligjit nr. 49/2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar (*ligji nr. 49/2012*) është i paankimueshëm në Gjykatën e Lartë, për pasojë ky vendim gjyqësor ka vendosur në mënyrë përfundimtare për pretendimet e kërkuases. Në këto rrethana, Gjykata çmon se kërkuessa e ka plotësuar kriterin e shterimit të mjeteve juridike, pasi nuk ka mjet tjetër ligjor për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese, pavarësisht përmbytjes së dispozitivit të vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit se ndaj këtij vendimi lejohet rekurs.

20. Po ashtu, Gjykata vlerëson se kërkuessa legjitimohet edhe *ratione temporis*, pasi vendimi i fundit gjyqësor i kundërshtuar prej saj është dhënë nga Gjykata Administrative e Apelit në datën 3.3.2020, ndërsa ankimi kushtetues individual është paraqitur në datën 2.7.2020, pra brenda afatit 4-mujor të parashikuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000.

21. Në drejtim të legjitimitetit *ratione materiae*, kërkuessa ka pretenduar se vendimi gjyqësor i kundërshtuar i ka cenuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor në aspektin e mosrespektimit të parimit të sigurisë juridike dhe të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor.

22. Gjithashtu, Gjykata vëren se edhe pse kërkuessa në themelin e kërtimeve të saj shprehimisht nuk pretendon cenimin e së drejtës së pronës, në objektin e kërkesës, si dhe në pjesën që argumenton legjitimitetin *ratione materiae* të saj, parashtron edhe cenimin e nenit 41 të Kushtetutës dhe të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, që garantojnë këtë të drejtë. Në këtë drejtim, Gjykata evidenton se detyrimet tatimore, duke përfshirë edhe gjobën, janë pjesë e konceptit kushtetues të

pronës, pasi pagesa e një sasive të caktuar të hollash, e barasvlershme me masën e detyrimit tatimor, gjobave dhe interesave, është një shumë që merret nga pasuria e tatimpaguesit, si pasojë e detyrimit që vetë atij i buron nga ligji, për të paguar detyrimet financiare (*shih vendimet nr. 10, datë 4.3.2021; nr. 16, datë 25.7.2008, të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Nga ana tjetër, Gjykata vëren se në këndvështrim të nenit 42 të Kushtetutës, prona nuk mund të cenohet pa një proces të rregullt ligjor dhe se kushdo, për mbrojtjen e së drejtës kushtetuese të pronës, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë. Për rrjedhojë, Gjykata, duke mbajtur në konsideratë se argumentet e paraqitura nga kërkuessa lidhen vetëm me procesin gjyqësor të zhvilluar ndaj saj dhe se objekti i kërkesës konsiston në shfuqizimin e vendimit gjyqësor të kundërshtuar dhe kthimin e çështjes për rigjykim në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, nuk do ta analizojë të drejtën e pronës në mënyrë autonome, por do ta shqyrtojë këtë pretendim të lidhur me cenimin e parimit të sigurisë juridike, si dhe me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor nga Gjykata Administrative e Apelit.

24. Në vlerësimin e Gjykatës, nisur edhe nga parimi i subsidiaritetit (*komplementaritetit*) që udhëheq raportin ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, kur shqyrtohen ankime individuale kushtetuese, të cilat kanë për objekt pretendime për procesin e rregullt ligjor, në rastet kur kjo Gjykatë konstaton cenimin e kësaj të drejte, atëherë gjykatat e juridiksionit të zakonshëm do të bëjnë një rivlerësim edhe të së drejtës substanciale që individi pretendon se cenohet, në rastin konkret të së drejtës së pronës.

25. Për sa më lart, në vijim Gjykata do të analizojë nëse procesi gjyqësor i zhvilluar nga Gjykata Administrative e Apelit, e cila ka dhënë vendimin që kundërshtohet nga kërkuessa, ka respektuar parimin e sigurisë juridike dhe standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e parimit të sigurisë juridike

26. Kërkuessa ka pretenduar se Gjykata Administrative e Apelit në vendimmarrjen e saj nuk ka marrë parasysh vendimin nr. 33, datë 8.6.2016, të Gjykatës Kushtetuese për shfuqizimin e nenit 14, të ligjit nr. 99/2015, i cili kishte ndryshuar nenin 119 të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, që ishte baza



ligjore e vendosjes së masës së gjobës ndaj kërkueses.

27. Subjekti i interesuar, Drejtoria Rajonale Tatimore, Tiranë, ka prapësuar se pretendimi për cenimin e parimit të sigurisë juridike është i pabazuar, pasi inspektorët e verifikimit të terrenit i kanë përmbushur detyrat e tyre. Gjithashtu, Gjykata Administrative e Apelit e ka shqyrtuar çështjen duke u bazuar në pretendimet e palëve dhe në provat shkresore që ekzistojnë në kohën e kryerjes së veprimit konkret administrativ, për të cilin momenti i konstatimit është i datës 6.11.2015, ndërsa njoftimi i vlerësimit është i datës 17.12.2015.

28. Subjekti i interesuar, Drejtoria e Apelit Tatimor, ka prapësuar se shfuqizimi i një ligji nga Gjykata Kushtetuese nënkupton zbatimin e dispozitës së mëparshme dhe jo moszbatimin e asnjë dispozite, për pasojë krijimin e një vakumi ligjor në veprimtarinë administrative.

29. Nenet 124 dhe 132 të Kushtetutës shprehën qartësisht në lidhje me forcën detyruese që vendimet e Gjykatës Kushtetuese kanë mbi të gjitha organet kushtetuese, autoritetet publike, duke përfshirë edhe gjykatat. Zbatimi i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese është detyrim kushtetues, ato kanë fuqi detyruese të përgjithshme dhe janë përfundimtare. Si të tilla, përbëjnë jurisprudencë kushtetuese dhe, për rrjedhojë, kanë efektet e forcës së ligjit. Ky efekt detyrues ka të bëjë si me pjesën urdhëruese, ashtu edhe me pjesën arsyetuese të vendimit. Efekti detyrues shtrihet tek argumentet thelbësore të vendimit, që përbëjnë edhe *ratio decidendi*, eliminimi i të cilave do ta bënte vendimin, në tërësinë e tij, të pakuptimtë (*shih vendimet nr. 49, datë 3.7.2017; nr. 15, datë 1.3.2017; nr. 44, datë 29.6.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

30. Nga ana tjetër, siguria juridike është ndër elementet thelbësore të shtetit të së drejtës, që sanksionohet në nenin 4 të Kushtetutës, si një prej parimeve themelore të organizimit shtetëror. Jurisprudenca kushtetuese ka pohuar se siguria juridike nënkupton, ndërmjet të tjerash, garantimin e besueshmërisë së individit të shteti, institucionet e tij dhe tek aktet që ato nxjerrin (*shih vendimet nr. 11, datë 16.4.2018; nr. 81, datë 18.12.2017, të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata, edhe gjatë shqyrtimit të ankesave individuale kushtetuese, e ka analizuar sigurinë juridike të lidhur me pretendimet për mosrespektimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese nga gjykatat e juridiksionit të

zakonshëm, duke theksuar se parimi i shtetit të së drejtës ku mbështetet një shtet demokratik, nënkupton sundimin e ligjit dhe mënjanimin e arbitraritetit, me qëllim që të arrihet respektimi dhe garantimi i dinjitetit njerëzor, drejtësisë dhe sigurisë juridike (*shih vendimet nr. 10, datë 4.3.2021; nr. 4, datë 15.2.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

31. Po ashtu, Gjykata ka pranuar se parimi themelor i shtetit të së drejtës lidhet edhe me të drejtën e procesit të rregullt ligjor, pasi kjo e fundit, ndër të tjera, ka për qëllim të garantojë shtetasit nga çdo veprim që u shkakton cenim të të drejtave të tyre, pa përjashtuar rastet kur cenimi vjen nga një akt i administratës shtetërore. Shteti i së drejtës presupozon se çdo ndërhyrje e autoriteteve ekzekutive në të drejtat e individit ose të personave juridikë duhet të jetë objekt i një kontrolli efektiv nga një organ që ofron garantimin e pavarësisë dhe paanësisë gjatë këtij procesi (*shih vendimet nr. 10, datë 4.3.2021; nr. 1, datë 16.1.2017, të Gjykatës Kushtetuese*).

32. Duke iu kthyer çështjes në gjykim, Gjykata konstaton se njoftimi i vlerësimit, i cili caktonte masën e gjobës ndaj kërkueses, është nxjerrë nga subjekti i interesuar, Drejtoria Rajonale Tatimore, Tiranë, në datën 17.12.2015 dhe është i bazuar në nenin 119 të ligjit nr. 9920/2008, të ndryshuar me nenin 14 të ligjit nr. 99/2015.

33. Kërkuesja i është drejtuar Drejtorisë së Apelit Tatimor për shfuqizimin e njoftimit të vlerësimit, e cila, me vendimin e datës 29.2.2016, ka vendosur lënien në fuqi të aktit administrativ edhe pse Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese në datën 23.12.2015 kishte vendosur pezullimin e zbatimit në tërësi të ligjit nr. 9920/2008. Në anën tjetër, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, e cila ka marrë në shqyrtim padinë e kërkueses, me objekt kundërshtimin e njoftimit të vlerësimit dhe të vendimit të Drejtorisë së Apelit Tatimor, ka vendosur pranimin e saj. Gjykata është bazuar në analizën e rrethanave faktike të konstatuara për vendosjen e masës së gjobës, duke arsyetuar se organet tatimore nuk e kanë vlerësuar drejt situatën faktike, pasi rezulton se shoqëria i ka paguar të gjitha detyrimet për të gjithë të punësuarit pranë saj (*shih fagen 9 të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë*).

34. Gjykata vëren se pas marrjes së vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 33, datë 8.6.2016 të Gjykatës Kushtetuese është vendosur shfuqizimi i disa prej



dispozitave, mes tyre edhe i nenit 14, që kishte ndryshuar nenin 119, i cili ishte edhe baza ligjore në vendosjen e masës së gjobës ndaj kërkujeses. Në këto rrethana edhe vetë kërkujesja në datën 27.2.2020 ka paraqitur në Gjykatën Administrative të Apelit shpjegime shtesë, duke parashtruar edhe argumente në lidhje me vendimmarrjen e Gjykatës Kushtetuese.

35. Gjithashtu, Gjykata vëren se Kuvendi, pas hyrjes në fuqi të vendimit të Gjykatës Kushtetuese, në zbatim të tij, ka bërë plotësimet e nevojshme ligjore me ligjin nr. 112/2016, i cili ka hyrë në fuqi në datën 30.11.2016.

36. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin e datës 3.3.2020, ka vendosur ndryshimin e vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe rrëzimin e padisë. Gjykata vëren se edhe pse vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit është dhënë pas hyrjes në fuqi të vendimit nr. 33, datë 8.6.2016 të Gjykatës Kushtetuese, ajo, në vendimin e saj, nuk është shprehur për këtë vendim, edhe pse bazuar në nenin 76 të ligjit nr. 8577/2000 vendimi i Gjykatës Kushtetuese ka fuqi prapavepruese, ndër të tjera, ndaj çështjeve që shqyrtohen nga gjykatat derisa vendimet e tyre nuk janë përfundimtare dhe të formës së prerë.

37. Duke marrë shkas nga çështja në shqyrtim, Gjykata rithekson ndikimin e padiskutueshëm të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, i cili është i tillë që iu imponon të gjitha organeve shtetërore, duke mos përjashtuar as gjykatat, fuqinë detyruese të arsyetimit të vendimeve të saj. Çdo qëndrim i kundërt krijon një precedent të rrezikshëm në marrëdhëniet institucionale (*shih vendimin nr. 18, datë 14.4.2015, të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë pikëpamje, Gjykata ka theksuar se nga standardi i detyrimit të zbatimit të vendimmarrjes kushtetuese nuk mund të bëjë përjashtim as vetë ajo (*shih vendimin nr. 44, datë 29.6.2015, të Gjykatës Kushtetuese*). Vendimi përfundimtar merr rëndësi të veçantë në rastet e shfuqizimit të ligjit ose të akteve normative. Ky lloj vendimi nënkupton mozbatimin e mëtejshëm të atij ligji ose akti normativ në praktikë jo vetëm nga palët në gjykimin kushtetues ose nga subjektet zbatuese të atij ligji ose akti normativ, por nga të gjitha autoritetet shtetërore, për më tepër nga gjykatat.

38. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se Gjykata Administrative e Apelit nuk ka përmbushur detyrimin kushtetues për zbatimin e vendimit të

Gjykatës Kushtetuese për shfuqizimin e ligjit, vendim i cili ka fuqi detyruese të përgjithshme dhe forcën e ligjit, si dhe nuk ka zbatuar as ndryshimet ligjore pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese, konkretisht ligjin nr. 112/2016.

39. Në analizë të fundit, Gjykata vlerëson se në çështjen konkrete zbatimi nga Gjykata Administrative e Apelit i dispozitave të një ligji të shfuqizuar nga Gjykata Kushtetuese, si dhe moszbatimi i dispozitave të reja ligjore në fuqi në kohën e shqyrtimit të çështjes, dëshmon se gjykata nuk ka ushtruar kontroll efektiv për ndërhyrjen që administrata tatimore ka bërë tek e drejta e pronës së kërkujeses, e, për rrjedhojë, ka cenuar parimin e sigurisë juridike. Në këtë mënyrë, Gjykata Administrative e Apelit nuk ka përmbushur detyrimin e saj për realizimin e një procesi të rregullt ligjor dhe gjykimi të drejtë, sipas nenit 42 të Kushtetutës. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkujeses është i bazuar.

B.2. Për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor

40. Kërkujesja ka pretenduar se Gjykata Administrative e Apelit ka cenuar standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, pasi nuk ka marrë në konsideratë rrethanat e reja të parashtruara prej saj për hyrjen në fuqi të vendimit të Gjykatës Kushtetuese për shfuqizimin e nenit 14 të ligjit nr. 99/2015. Gjithashtu, përmbajtja e dispozitivit të vendimit nuk përputhet me arsyetimin e tij, pasi Gjykata Administrative e Apelit në dispozitiv shprehet se ndaj vendimit mund të ushtrohet rekurs, ndërsa në përmbajtje të tij ka arsyetuar se bazuar në nenin 56 të ligjit nr. 49/2012 vendimi është i formës së prerë dhe i paankimueshëm.

41. Subjekti i interesuar, Drejtoria Rajonale Tatimore, Tiranë, ka prapësuar se pretendimi i kërkujeses për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor është i pabazuar në ligj dhe në prova. Gjykata ka analizuar plotësisht kërkimet e paditësit, duke arritur në konkluzionin e drejtë se vendimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë duhet të ndryshohet dhe padia të rrëzohet. Ndërsa subjekti i interesuar, Drejtoria e Apelit Tatimor, u është përmbajtur të njëjtave prapësime të paraqitura për parimin e zbatimit të ligjit të kohës së konstatimit të shkeljes, pavarësisht se çështja ishte ende në shqyrtim në momentin e shfuqizimit të tij.



42. Në lidhje me standardin e arsyetimit, Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se e drejta për një proces të rregullt përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funkcioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimin nr. 18, datë 15.3.2016, të Gjykatës Kushtetuese*). Nëpërmjet arsyetimit, gjyqtari tregon me qartësi faktet dhe ligjin e zbatueshëm që e kanë çuar në bërjen e një zgjedhjeje ndërmjet disa mundësive. Vendimet gjyqësore që japin gjykatat e të gjitha niveleve në përfundim të gjykimit përbëjnë aktin procedural kryesor të të gjithë procesit gjyqësor. Ato përmbledhin dhe finalizojnë përfundimisht qëndrimet që mban gjykata lidhur me çështjen në gjykim (*shih vendimin nr. 18, datë 15.3.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

43. Gjykata e ka vlerësuar zbatimin e këtij standardi, rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e vendimeve të tyre. Ajo ka verifikuar nëse vendimi i kundërshtuar është logjik, ka kundërtënie, përmban referenca në ligjin e zbatueshëm dhe nëse respekton të gjitha elementet e sipërpërmendura. Detyrimi i gjykatave për të respektuar këtë standard ndryshon në varësi të rrethanave të çështjes konkrete, të natyrës së vendimit dhe masa e arsyetimit varet nga natyra e vendimit në fjalë (*shih vendimin nr. 25, datë 10.6.2011, të Gjykatës Kushtetuese*).

44. Në këtë kontekst, Gjykata ka theksuar se ajo e vlerëson arsyetimin e një vendimi gjyqësor vetëm në kuadrin e përmbushjes ose jo të standardeve të mësipërme, pasi nuk është detyrë e saj të analizojë provat dhe faktet ku është bazuar gjykata për zgjidhjen e çështjes së themelit. Kjo mbetet detyrë funksionale e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Ndërsa në aspektin e kontrollit kushtetues, Gjykata verifikon nëse arsyetimi i vendimit gjyqësor i ka plotësuar ose jo kriteret e përcaktuara, të cilat garantojnë të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar (*shih vendimin nr. 18, datë 15.3.2016, të Gjykatës Kushtetuese*). Pra, sipas Gjykatës, nuk mjafton që arsyetimi të jetë formalisht i paraqitur në kuptimin grafik dhe

strukturor, pasi kjo do ta bënte atë thjesht fiktiv. Arsyetimi duhet domosdoshmërisht të plotësojë kriteret minimale ligjore të përcaktuara dhe të mos ketë të meta të tilla serioze që cenojnë standardin e vendimit gjyqësor të arsyetuar (*shih vendimin nr. 55, datë 18.12.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

45. Duke iu kthyer çështjes në shqyrtim, Gjykata vëren se vendimi i dhënë nga Gjykata Administrative e Apelit lidhet me parashtrimin e rrethanave faktike gjatë ushtrimit të kontrollit tatimor nga inspektorët për përpilimin e aktit të konstatimit (*si ushtrimi i kontrollit në adresën e saktë dhe fakti që personi që ndodhej në ambientet e shoqërisë ishte i punësuar faktikisht, por i padëklaruar ditën e ushtrimit të kontrollit*), që e ka çuar në përfundimin se aktet administrative (*njoftimi i vlerësimit tatimor dhe vendimi i Drejtorisë së Apelit Tatimor*) ishin të bazuara në ligj. Gjithashtu, Gjykata Administrative e Apelit ka arsyetuar: “Kjo sjellje e tatimpaguesit është e kundërligjshme dhe e sanksionueshme në masën 500 000 lekë, sipas neni 119 të ligjit nr. 9920/2008, të ndryshuar (në fuqi në kohën e kryerjes së kundërvajtjes tatimore). Këtë shkelje të palës paditëse, pala e paditur DRT Tiranë, në zbatim korrekt të ligjit për procedurat tatimore, ia ka njoftuar palës së paditur, nëpërmjet vlerësimit tatimor nr. 78611/2 prot., datë 17.12.2015. I tillë është edhe vendimi i DAT nr. 11681/1, datë 29.2.2016, që ka lënë në fuqi këtë njoftim vlerësimi tatimor.” (*shih faqen 14 të vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë*).

46. Gjykata konstaton se Gjykata Administrative e Apelit në përmbajtjen e vendimit nuk ka pasqyruar pretendimet shtesë të parashtruara nga kërkuesja për hyrjen në fuqi të vendimit nr. 33, datë 8.6.2016 të Gjykatës Kushtetuese, të depozituara në sekretarinë gjyqësore në datën 27.2.2016. Gjithashtu, në vendim ajo nuk ka arsyetuar për zbatimin në rastin në shqyrtim të vendimit të Gjykatës Kushtetuese për shfuqizimin e nenit 119, të ndryshuar (*baza ligjore në vendosjen e gjobës ndaj kërkueses*).

47. Për sa më lart, Gjykata çmon se në rastin konkret vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit nuk ka arritur të përmbushë kërkesat për t'u konsideruar i arsyetuar, në kuptim të standardeve kushtetuese dhe në respektim të kërkesave të dispozitave përkatëse procedurale. Gjykata Administrative e Apelit edhe pse formalisht e ka justifikuar vendosjen e masës së gjobës duke argumentuar se në rastin konkret do të aplikohet ligji në fuqi në kohën e kryerjes së kontrollit,



arsyetimi i saj nuk është i qartë, logjik dhe në analizë të plotë të të gjitha rrethanave faktike e ligjore. Ajo nuk ka argumentuar qëndrimin e saj se pse duhet të vazhdojë të zbatohet neni 119 i ligjit nr. 9920/2008 edhe pas shfuqizimit të tij nga Gjykata Kushtetuese, si dhe pas hyrjes në fuqi të dispozitave të reja ligjore. Gjithashtu, ajo nuk ka analizuar të gjitha pretendimet e parashtruara nga palët, çka e bën vendimin e Gjykatës Administrative të Apelit me të meta të tilla që nuk çojnë në arritjen e një përfundimi logjik nga ana e saj.

48. Për pretendimin e parashtruar nga kërkuësja se ka mospërputhje mes përmbajtjes së dispozitivit dhe pjesës arsyetuese të vendimit, pasi Gjykata Administrative e Apelit në dispozitiv shprehet, se: “*ndaj vendimit mund të ushtrohet rekurs*”, Gjykata konstaton se ka të bëjë me një gabim material në vendim. Vetë Gjykata Administrative e Apelit në paragrafin e fundit të pjesës arsyetuese është shprehur se bazuar në nenin 56 të ligjit nr. 49/2012, vendimi është i formës së prerë dhe i paankimueshëm, duke përllogaritur edhe vlerën në të holla të masës së gjobës, e cila është më e vogël se dyfishi i pagës minimale në shkallë vendi.

49. Si përfundim, Gjykata vlerëson se kërkesa e shoqërisë “MC Networking” sh.p.k. për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtëm të parimit të sigurisë juridike dhe të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, e lidhur me to edhe të së drejtës së pronës, është e bazuar.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e vijuese të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës.
2. Shfuqizimin e vendimit nr. 486 (86-2020-556), datë 3.3.2020 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.
3. Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 30.3.2021.

Shpallur më 28.4.2021.

Kryetare: Vitore Tusha

Anëtarë: Marsida Xhaferllari, Elsa Toska, Përparim Kalo, Altin Binaj, Fiona Papajorgji, Sonila Bejtja

VENDIM

Nr. 19, datë 1.4.2021

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vitore Tusha	kryetare e Gjykatës Kushtetuese		
Elsa Toska	anëtare e	“	“
Marsida Xhaferllari	anëtare e	“	“
Fiona Papajorgji	anëtare e	“	“
Altin Binaj	anëtar i	“	“
Përparim Kalo	anëtar i	“	“
Sonila Bejtja	anëtare e	“	“

me sekretare Belma Lleshi, në datën 1.4.2021, mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë dokumentesh çështjen nr. 8 (S) 2018 të Regjistrat Themeltar, që u përket:

KËRKUES: Skerdilajd Qinami

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Gleni Saliasi, Ardit Bardhi, Banka Amerikane e Investimeve

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 5545, datë 6.5.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr. 88, datë 19.2.2015, të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 00-2017-2314 (155), datë 23.11.2017, të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Pezullimi i zbatimit të vendimeve nr. 88, datë 19.2.2015, të Gjykatës së Apelit Tiranë, dhe nr. 00-2017-2314 (155), datë 23.11.2017, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).



GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes, Vitore Tusha, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkesit, i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjekteve të interesuara, Ardit Bardhi dhe Banka Amerikane e Investimeve (*më parë Banka Kombëtare e Greqisë*), konstatoi mungesën e parashtrimeve të subjektit të interesuar, Gleni Saliasi, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Gleni Saliasi (*subjekt i interesuar*) ka qenë pronar i një trualli me sipërfaqe 630 m², që ndodhet në Tiranë në zonën kadastrale nr. 8260, siç rezulton nga regjistri hipotekor nr. 397, datë 3.3.1999.

2. Me vendimin nr. 36, datë 23.7.1999, Këshilli i Rregullimit të Territorit ka miratuar lejen e ndërtimit për pikë karburanti e objekt 2-katësh në pronë të shtetasit Gleni Saliasi në bulevardin “Bajram Curri” për një sipërfaqe prej 670 m².

3. Për të projektuar dhe ndërtuar këtë pikë karburanti në rrugën “Bajram Curri”, Tiranë, është nënshkruar më parë një kontratë sipërmarrjeje midis shoqërisë italo-shqiptare të karburanteve “IAP” sh.p.k. (*sipërmarrësi*) dhe shoqërisë “Skerdi” sh.p.k. (*pomsiësi*) në datën 20.6.1999. Nga aktet e dosjes gjyqësore (ekstrakt i QKR-së) rezulton se shoqëria “Skerdi” sh.p.k. në vitin 1999 ka pasur ortake të vetme me 100% të pjesëve të kapitalit shtetasen Nadire Qinami, e cila ka qenë edhe administratore e shoqërisë. Më pas, në datën 10.5.2000, kjo shoqëri ka ndryshuar emrin në “Brilant” sh.p.k. dhe pjesët e kapitalit i kanë kaluar kërkesit me 100% deri në datën 10.1.2010, datë kur këto pjesë kapitali i kanë kaluar sërish Nadire Qinamit me 100%. Pas përfundimit të ndërtimit të pikës së karburantit, objekti është regjistruar në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZRPP) në emër të subjektit të interesuar, Gleni Saliasi, në regjistrin hipotekor nr. 621, ZK 8260, datë 15.12.2000.

4. Subjekti i interesuar, Gleni Saliasi, me anë të kontratës së shitjes nr. 4179 rep., nr. 415 kol, datë 2.9.1999, u ka shitur 2/3-at pjesë të truallit me sipërfaqe 630 m² në pronësi të tij, kërkesit dhe

subjektit tjetër të interesuar, Ardit Bardhi, përkatësisht 1/3-n pjesë secilit. Këta tre bashkëpronarë e kanë regjistruar truallin në regjistrin hipotekor nr. 261, datë 3.9.1999.

5. Kërkesi dhe subjektet e interesuara, Gleni Saliasi dhe Ardit Bardhi, kanë blerë një truall me sipërfaqe prej 50 m² me anë të kontratës së shitblerjes nr. 4166 rep., 2124 kol., datë 6.7.2002, të regjistruar në hipotekë me nr. 5814, datë 13.12.1997, zona kadastrale nr. 8260, Tiranë.

6. Po ashtu, me kontratën e shitblerjes nr. 1140 rep., nr. 363 kol., datë 6.3.2003 subjekti i interesuar, Gleni Saliasi, në cilësinë e pronarit, u ka shitur kërkesit dhe subjektit tjetër të interesuar, Ardit Bardhi, nga 1/3-n pjesë të pikës së karburantit dhe objektit 2-katësh të ndodhur në rrugën “Bajram Curri”, me sipërfaqe 670 m² (shesh) dhe 170 m² (sipërfaqe ndërtimore).

7. Pronat e mësipërme janë të regjistruara në ZVRPP-në, Tiranë në emër të tre bashkëpronarëve (Gleni Saliasi, Skerdilajd Qinami dhe Ardit Bardhi), me pjesë takuese 1/3-at secili. Konkretisht, këto prona janë: trualli me sipërfaqe 96 m², me nr. pasurie 1/380, sipas regjistrin hipotekor nr. 544, datë 20.7.2005 dhe trualli me sipërfaqe 584 m², mbi të cilin ndodhet pika e karburantit me sipërfaqe 170 m², me nr. pasurie 1/381, sipas regjistrin hipotekor nr. 545, datë 20.7.2005.

8. Me pëlqimin e të tre bashkëpronarëve, pronat e mësipërme, me nr. pasurie 1/380 dhe nr. 1/381, i janë dhënë me qira shoqërisë “KUID” sh.p.k., me kontratën nr. 672 rep., 169 kol., datë 6.10.2006.

9. Gjithashtu, të njëjtat prona janë vendosur si garanci hipotekore nga ana e kërkesit dhe dy subjekteve të interesuara, Gleni Saliasi dhe Ardit Bardhi, për sigurimin e një kredie të marrë në datën 11.2.2008 nga Banka Kombëtare e Greqisë (aktualisht Banka Amerikane e Investimeve). Në vitin 2011 Banka Kombëtare e Greqisë ka ndryshuar emërtimin në Banka NBBG Albania sh.a. dhe në vitin 2018 është bashkuar me Bankën Amerikane të Investimeve sh.a. Parashtrimet në Gjykatën Kushtetuese (*Gjykata*) janë paraqitur nga Banka Kombëtare e Greqisë, në cilësinë e palës së tretë gjatë gjykimit të themelit të mosmarrëveshjes.

10. Mes bashkëpronarëve nuk është arritur një marrëveshje për pjesëtimin e pasurisë së mësipërme, prandaj subjektet e interesuara, Gleni Saliasi dhe Ardit Bardhi, i kanë kërkuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë pjesëtimin e pasurisë së



paluajtshme në bashkëpronësi: truall me sipërfaqe 96 m², i ndodhur në rrugën “Bajram Curri”, i regjistruar me nr. 544, datë 20.7.2005, i identifikuar me nr. pasurie 1/380, dhe truall me sipërfaqe 584 m², mbi të cilin ndodhet pika e karburantit me sipërfaqe 170 m², i ndodhur në rrugën “Bajram Curri”, i regjistruar me nr. 545, datë 20.7.2005, i identifikuar me nr. pasurie 1/381.

11. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 5545, datë 6.5.2014, ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë së paraqitur nga subjektet e interesuara, duke arsyetuar, në mënyrë të përmbledhur, se paditësve u mungon interesi i ligjshëm, pasi nuk kanë kërkuar në padi pjesëtimin e pasurisë “pikë karburanti” dhe Banka Kombëtare e Greqisë, në cilësinë e kreditorit, ka refuzuar pjesëtimin e pasurisë.

12. Kundër vendimit të mësipërm kanë paraqitur ankim si kërkuesi, ashtu edhe subjektet e interesuara, Gleni Saliasi dhe Ardit Bardhi. Subjekti i interesuar, Banka Kombëtare e Greqisë, në datën 19.2.2015, i është drejtuar me shkresë Gjykatës së Apelit Tiranë, duke dhënë pëlqimin për pjesëtimin e pasurisë së paluajtshme në bashkëpronësi.

13. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 88, datë 19.2.2015, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. 5545, datë 6.5.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, pranimin e kërkesëpadisë, lejimin e pjesëtimin të pasurisë së paluajtshme në bashkëpronësi të Gleni Saliasit, Skerdilajd Qinamit dhe Ardit Bardhit: truall me sipërfaqe 96m², i ndodhur në rrugën “Bajram Curri”, i regjistruar me nr. 544 hipotekor, datë 20.7.2005 në ZVRPP-në, Tiranë, i identifikuar me nr. pasurie 11380, ZK 8260, i kufizuar: veriu – pasuria 1/923, jugu – pasuria 1/196, lindje – pasuria 1/196, perëndim – pasuria 1/381; ii) truall me sipërfaqe 584 m² mbi të cilin ndodhet pika e karburantit me sipërfaqe 170 m², i ndodhur në rrugën “Bajram Curri”, i regjistruar me nr. 545 hipotekor, datë 20.7.2005 në ZVRPP-në, Tiranë, i identifikuar me nr. pasurie 11380, ZK 8260, i kufizuar: veriu – pasuria 1/193, jugu – pasuria 1/196, lindje – pasuria 1/380, perëndim – pasuria 1/190, sipas pjesëve takuese: Gleni Saliasi 1/3-n pjesë takuese; Ardit Bardhi 1/3-n pjesë takuese dhe Skerdilajd Qinami 1/3-n pjesë takuese.

14. Gjykata e Lartë ka shqyrtuar në seancë gjyqësore rekursin e paraqitur nga kërkuesi dhe me vendimin nr. 00-2017-2314 (155), datë 23.11.2017

ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 88, datë 19.2.2015, të Gjykatës së Apelit Tiranë.

15. Në datën 14.2.2018 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës për shfuqizimin e vendimeve gjyqësore, sipas objektit të kërkesës. Kolegji i Gjykatës në datën 23.5.2018 ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë dokumentesh.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

16. *Kërkuesi, Skerdilajd Qinami*, ka pretenduar se ndaj tij është zhvilluar një proces i parregullt ligjor. Më konkretisht, ai ka parashtruar, në mënyrë të përmbledhur, se janë cenuar:

16.1 *Parimi i barazisë së armëve*, për shkak se kërkuesi nuk ka qenë në pozita të barabarta në paraqitjen e provave gjatë gjykimit në shkallë të parë. Sipas tij, gjykata e shkallës së parë nuk e ka gjykuar çështjen në themel, ndaj dhe padia nuk i është nënshtruar procesit të të provuarit në lidhje me pjesët takuese të pretenduara nga palët. Kërkuesi ka paraqitur si prova mandat -pagesa, mandat- arkëtime, si dhe akte të tjera shkresore për të provuar se shoqëria “Skerdi” sh.p.k. ka dhënë kontributin më të madh në pasurinë e përbashkët, në raport me dy bashkëpronarët e tjerë, prova të cilat nuk janë marrë në shqyrtim dhe nuk janë vlerësuar nga gjykata e shkallës së parë. Edhe gjykata e apelit nuk i ka vlerësuar provat e kërkuetit për dhënie të një kontributi më të madh në pasurinë e përbashkët.

16.2 *E drejta e aksesit në gjykatë*, pasi gjykata e shkallës së parë nuk e ka shqyrtuar çështjen në themel. Po kështu, gjykata e apelit, për shkak të shkeljeve të evidentuara, duhet ta kishte prishur vendimin e gjykatës së shkallës së parë dhe ta dërgonte çështjen për rishqyrtim në po atë gjykatë ose të përsëriste hetimin gjyqësor, gjë që nuk e ka bërë. Edhe Gjykata e Lartë, sipas kërkuetit, nuk i ka korrigjuar këto mangësi, çka e bën vendimin e saj të cenueshëm.

16.3 *Standardi i arsyetimit të vendimit gjyqësor* nga gjykata e apelit, pasi vendimi i gjykatës së apelit është i paargumentuar, i pambështetur në prova shkresore, i paqartë dhe, për rrjedhojë, i pambështetur në ligj. Nga ana tjetër, edhe vendimi i Gjykatës së Lartë ka mangësi në drejtim të garantimit të standardit të arsyetimit, për arsye se Gjykata e Lartë nuk i ka dhënë përgjigje



pretendimit të kërkuarit në lidhje me cenimin e standardit të arsyetimit nga gjykata e apelit.

17. Kërkuar ka kërkuar, gjithashtu, edhe pezullimin e zbatimit të vendimeve nr. 88, datë 19.2.2015, të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr. 00-2017-2314 (155), datë 23.11.2017, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, pasi për shkak të paqartësisë së pjesëve takuese dhe pandashmërisë së pikës së karburantit nga trualli, ekzekutimi i këtyre vendimeve gjyqësore nuk garanton të drejtat e kërkuarit.

18. **Subjekti i interesuar, Ardit Bardhi**, ka prapësuar si vijon:

18.1 Kërkuar i është dhënë mundësia të paraqesë të gjitha provat për të vërtetuar pretendimin se ka dhënë kontribut më të madh në pasurinë e përbashkët. Ndryshe nga sa pretendon, kërkuar nuk ka paraqitur kërkesë në gjykatën e apelit për përsëritjen e hetimit gjyqësor ose marrjen e provave të reja. Gjykata e apelit i ka analizuar me hollësi pretendimet e palëve ndërgjyqëse, si dhe provat shkresore që kanë çuar në konkluzionin e arritur në vendim. Po kështu, edhe Gjykata e Lartë u ka dhënë përgjigje pretendimeve të kërkuarit, i cili në asnjë moment të procesit nuk është gjendur në pamundësi për të ushtruar të drejtat e tij në lidhje me faktet, provat dhe vlerësimet ligjore të gjykatave.

18.2 Pretendimi i kërkuarit se i është cenuar e drejta e aksesit në gjykim, është i papabuar. Kërkuar e ka ushtruar këtë të drejtë duke vënë në lëvizje gjykatën e apelit dhe Gjykatën e Lartë, të cilat u kanë dhënë përgjigje pretendimeve të ngritura prej tij në vendimet përkatëse.

18.3 Në çështjen konkrete, vendimet gjyqësore e plotësojnë standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor jo vetëm nga pikëpamja formale, por edhe në aspektin substancial. Ndryshe nga sa pretendon kërkuar, gjykata e apelit dhe Gjykata e Lartë në vendimet e tyre, kanë marrë parasysh dhe vlerësuar pretendimet e kërkuarit, u janë referuar dispozitave ligjore për zgjidhjen e çështjes dhe nëpërmjet argumentimit ligjor kanë nxjerrë konkluzionin që përmban dispozitivi i secilit vendim gjyqësor.

19. **Subjekti i interesuar, Banka Amerikane e Investimeve**, ka paraqitur si vijon:

19.1 Gjatë gjykimit të çështjes banka e ka dhënë pëlqimin për pjesëtimin e pasurisë së paluajtshme në bashkëpronësi, duke iu referuar kërkesës së kërkuarit drejtuar bankës për lejimin e pjesëtimin.

Banka ka theksuar se kushti që duhet të plotësohet është se edhe pas pjesëtimin pronat e mësipërme do të vazhdojnë të qëndrojnë të bllokuara (të hipotekuara) në favor të bankës për sigurimin e kredisë së marrë nga palët.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

20. Gjykata vë në dukje se prej datës 23 mars të vitit 2018 nuk ka pasur kuorumin e nevojshëm ligjor të kërkuar nga neni 32, pika 1 të ligjit nr. 8577/2000 për funksionimin e saj dhe shqyrtimin e çështjeve në seancë plenare. Pas plotësimit të këtij kuorumi u bë e mundur marrja në shqyrtim e kësaj çështjeje.

A. Për pezullimin e zbatimit të aktit

21. Kërkuar ka kërkuar pezullimin e zbatimit të vendimeve nr. 88, datë 19.2.2015, të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr. 00-2017-2314 (155), datë 23.11.2017, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, pasi për shkak të paqartësisë së pjesëve takuese dhe natyrës komplekse të pikës së karburantit, e cila është e lidhur pandashmërisht me truallin, vënia në ekzekutim e vendimeve dhe vijimi me fazën e dytë të pjesëtimin nuk garantojnë të drejtat e kërkuarit.

22. Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, në bazë të nenit 45 të ligjit nr. 8577/2000, pasi mori në shqyrtim shkaqet e parashtruara nga kërkuar, me vendimin e datës 12.1.2021, vendosi ta vlerësojë pezullimin e zbatimit të vendimeve gjyqësore në seancë plenare së bashku me tërësinë e kërkesës së paraqitur nga kërkuar dhe parashtrimet e palëve.

23. Gjykata, në mbështetje të nenit 45 të ligjit nr. 8577/2000, ka kompetencë të vlerësojë nëse zbatimi i aktit mund të sjellë pasoja që prekin interesa shtetërore, shoqërore ose të individëve, sipas rastit, çka përbën kriterin thelbësor për pezullimin e ekzekutimit të këtij akti. Gjykata vlerëson se në kuptim të dispozitës së sipërcituar, kërkuar nuk paraqiti argumente në lidhje me pasojat e rënda ose të pariparueshme që do të sillte zbatimi i vendimeve gjyqësore. Për rrjedhojë, Gjykata vendosi rrëzimin e kërkesës për pezullim si të papabuar.

B. Për legjitimitetin e kërkuarit

24. Gjykata vëren se, sipas neneve 131, pika 1, shkronja “P”, 134, pika 1, shkronja “I” dhe 134, pika 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr.



8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, kur është palë në një proces ligjor ose kur është bartës i të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara nga Kushtetuta, mund të vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, llojin e pasojave negative të pësuar, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprirak të kërkesës.

25. Kërkuesi legjitimohet *ratione personae* bazuar në rregullimin e parashikuar në nenet 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin civil në të cilin janë marrë vendimet që kundërshton përpara kësaj Gjykate.

26. Sipas nenit 131, pika 1, shkronja “P”, të Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese vendos për gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese, që individit pretendon se i janë cenuar nga akti i pushtetit publik. Shterimi i mjetit është kusht si në rastet e kundërshtimit të një vendimi gjyqësor, sipas nenit 71/a, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 8577/2000, i lartpërmendur, ashtu edhe në rastet e kundërshtimit të një dispozite ligjore/ligji.

27. Në çështjen konkret rezulton se vendimi i fundit që ka përmbyllur procesin gjyqësor dhe ka vendosur në mënyrë përfundimtare për pretendimet e kërkuesit është vendimi i Gjykatës së Lartë, objekt shqyrtimi. Po ashtu, për sa U përket pretendimeve ndaj vendimit të gjykatës së apelit, rezulton se ai i ka ngritur këto pretendime në rekurs. Në këto rrethana, Gjykata çmon se kërkuesi e ka plotësuar kriterin e shterimit të mjeteve juridike, pasi nuk ka mjet tjetër ligjor për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese.

28. Në lidhje me legjitimitimin *ratione temporis*, në kuptim të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, individit, pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e të drejtave të tij, mund ta paraqesë kërkesën në Gjykatën Kushtetuese brenda 4 muajve nga konstatimi i cenimit. Në rastin në shqyrtim, vendimi i Gjykatës së Lartë, i cili ka mbyllur procesin gjyqësor në gjykatat e zakonshme, mban datën 23.11.2017, ndërsa kërkesa në Gjykatën Kushtetuese është paraqitur në datën

14.2.2018, pra brenda afatit 4-mujor të parashikuar nga ligji. Rrjedhimisht, kërkuesi legjitimohet *ratione temporis* t'i drejtohet Gjykatës.

29. Për sa i përket legjitimitimit *ratione materiae*, Gjykata vëren se kërkuesi ka ngritur pretendime, të cilat lidhen me të drejtën kushtetuese për një proces të rregullt ligjor. Konkretisht, në thelb ai ka pretenduar se janë cenuar parimi i barazisë së armëve, e drejta e aksesit në gjykatë dhe standardi i arsytimit të vendimit gjyqësor. Këto pretendime të kërkuesit janë shqyrtuar në vijim nga Gjykata.

C. Për themelin e pretendimeve

C.1. Për pretendimin e cenimit të parimit të barazisë së armëve

30. Kërkuesi ka pretenduar se është cenuar parimi i barazisë së armëve, për shkak se ai nuk ka qenë në pozita të barabarta për sa i përket paraqitjes së provave gjatë gjykimin në shkallë të parë. Sipas tij, gjykata e shkallës së parë nuk e ka gjykuar çështjen në themel, ndaj dhe padia nuk i është nënshtruar procesit të të provuarit në lidhje me pjesët takuese të pretenduara nga palët. Kërkuesi ka paraqitur si prova mandat-pagesa dhe mandat-arkëtime, si dhe akte të tjera shpresore për të provuar se shoqëria “Skerdi” sh.p.k. ka dhënë kontributin më të madh në pasurinë e përbashkët, në raport me dy bashkëpronarët e tjerë, prova të cilat nuk janë marrë në shqyrtim dhe nuk janë vlerësuar nga gjykata e shkallës së parë. Edhe gjykata e apelit nuk i ka vlerësuar provat e kërkuesit për dhënien e një kontributi më të madh në pasurinë e përbashkët.

31. Subjekti i interesuar, Ardit Bardhi, ka parashtruar se kërkuesit i është dhënë mundësia që të paraqesë të gjitha provat për të vërtetuar pretendimin se ka dhënë kontribut më të madh në pasurinë e përbashkët. Ndryshe nga sa pretendon, kërkuesi nuk ka paraqitur kërkesë në gjykatën e apelit për përsëritjen e hetimit gjyqësor ose marrjen e provave të reja. Gjykata e apelit i ka analizuar me hollësi pretendimet e palëve ndërgjygjëse, si dhe provat shpresore që kanë çuar në konkluzionin e arritur në vendim. Po kështu, edhe Gjykata e Lartë u ka dhënë përgjigje pretendimeve të kërkuesit, i cili në asnjë moment të procesit nuk është gjendur në pamundësi për të ushtruar të drejtat e tij në lidhje me faktet, provat dhe vlerësimet ligjore të gjykatave.

32. Parimi i barazisë së armëve nënkupton se çdokush që është palë në proces duhet të ketë



mundësi të barabarta që të paraqesë çështjen e tij dhe se asnjë palë nuk duhet të gëzojë avantazh të konsiderueshëm ndaj palës tjetër, por duhet të përcaktohet një ekuilibër i drejtë mes palëve. Nëse nuk do të ekzistonte barazia e armëve në gjykim, atëherë argumentet e njëres palë do të mbizotëronin mbi argumentet e palës tjetër, për rrjedhojë e drejta për të marrë pjesë në gjykim do të zhvishej nga funksioni i saj kushtetues për të garantuar një proces të rregullt ligjor. Bazuar në këto parime, gjykatës i dalin një sërë detyrash, mes të cilave rëndësi të veçantë merr krijimi i mundësive të barabarta për pjesëmarrjen e palëve ose përfaqësuesve të tyre në proces, si dhe mundësia e deklarimit të tyre për faktet, provat dhe vlerësimet ligjore që janë të lidhura ngushtë me çështjen që shqyrtohet në gjykatë (*shih vendimet nr. 21, datë 20.3.2017; nr. 28, datë 22.5.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

33. Në jurisprudencën kushtetuese është evidentuar dallimi që ekziston ndërmjet mënyrës së marrjes të provave dhe vlerësimit të tyre në një proces gjyqësor. Gjykata ka theksuar se vlerësimi, dobishmëria dhe rëndësia e tyre provuese në një çështje konkrete është, si rregull, detyrë e gjykatave të sistemit gjyqësor, ndërsa verifikimi i ligjshmërisë së krijimit dhe marrjes së provave i nënshtrohet edhe kontrollit të Gjykatës Kushtetuese, pasi ky aspekt i gjykimit ka lidhje të drejtpërdrejtë me procesin e rregullt ligjor. Gjykata mund dhe duhet të investohet kur ndaj një procesi gjyqësor ka pretendime për rrugën e mënyrën e marrjes dhe fiksimit të provave, por jo të vlerësimit të tyre. Marrja e provave, paraqitja dhe vlerësimi i tyre janë në juridiksion të gjykimit të zakonshëm dhe jo atij kushtetues. Është vetë gjykata e zakonshme që vlerëson nëse provat duhet të merren dhe mënyra e vlerësimit dhe konkluzionet lidhur me to janë po ashtu në kompetencë të saj (*shih vendimet nr. 21, datë 20.3.2017; nr. 9, datë 26.2.2015, të Gjykatës Kushtetuese*). Po ashtu, parimi i barazisë së armëve nuk u imponon gjykatave të juridiksionit të zakonshëm që të pranojnë të gjitha argumentet dhe provat që paraqet një palë në proces. Kur kryen detyrën e saj të vlerësimit të lirë të provave, gjykata mund të bindet mbi bazën e disa provave, duke përjashtuar një ose disa prova të tjera, që ajo i konsideron të parëndësishme për çështjen (*shih vendimin nr. 19, datë 19.7.2005, të Gjykatës Kushtetuese*).

34. Duke iu rikthyer çështjes konkrete, kërkuesi ka argumentuar se gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e apelit nuk i kanë marrë parasysh provat, të cilat vërtetojnë kontributin e shoqërisë “Skerdi” sh.p.k., me ortak e administrator të vetëm kërkuesin, në ndërtimin dhe vënien në funksionim të pikës së karburantit të ndërtuar në truallin e përbashkët. Në parashtrimet e tij përpara këtyre gjykatave ai ka pretenduar se kontributi në pronën aktuale nga secili bashkëpronar ka qenë në këto raporte: Gleni Saliasi 1.56%; Ardit Bardhi 1.56%; kërkuesi 96.87%. Bazuar në këto kontribute, sipas kërkuesit, gjykata nuk duhej të bënte një pjesëtim të barabartë të pronës mes bashkëpronarëve, por duhej të merrte parasysh kontributet e secilit prej tyre në përcaktimin e pjesëve takuese.

35. Gjykata, nga aktet e dosjes gjyqësore, konstaton se gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e apelit i kanë administruar dhe shqyrtuar provat e paraqitura prej tij. Kështu, gjykata e shkallës së parë i ka bërë pjesë të shqyrtimit gjyqësor, duke i përfshirë ato në aktet e administruara në cilësinë e provave shpresore (*f. 11–13 të vendimit të gjykatës së shkallës së parë*). Edhe gjykata e apelit ka arsyetuar mbi ligjshmërinë e fitimit të bashkëpronësisë dhe ka analizuar pretendimet e kërkuesit në lidhje me këtë fakt, duke u shprehur, në mënyrë të përmbledhur: “Ana e paditur, Skerdilajd Qinami nuk arrin të vërtetojë që kontributi i tij në vënien e kësaj pasurie është më i madh se i paditësve. Pretendimi i të paditurit se në vënien e kësaj pasurie ka kontribuar më shumë si bashkëpronar pasi investimi kryesor është bërë nga shoqëria “Skerdi” sh.p.k., ku i padituri ka qenë ortak i vetëm nuk vërtetohet nga provat e administruara në seancë gjyqësore (...) Bashkëpronësia për palën paditëse Ardit Bardhi dhe të paditurin Skerdilajd Qinami është fituar në mënyrë të prejardhur (neni 164 i Kodit Civil) nëpërmjet veprimeve juridike të tjetërsimit (kontratë noteriale shitblerje) nr. 1140 rep., 363 kol., datë 6.3.2003.” (*f. 16 e vendimit të gjykatës së apelit*).

36. Gjykata vëren se kërkuesit i është dhënë mundësia, gjatë procesit të zhvilluar në gjykatën e shkallës së parë dhe gjykatën e apelit, që të kundërshtojë raportin e pjesëve takuese në bashkëpronësi, të debatojë në lidhje me to, si dhe të paraqesë argumente dhe prova në mbështetje të pretendimeve të tij. Bazuar në jurisprudencën e mësipërme të Gjykatës, marrja e provave, paraqitja dhe vlerësimi i tyre janë në juridiksion të gjykimit të zakonshëm dhe jo atij kushtetues. Për rrjedhojë, në



vështrim të kësaj jurisprudence dhe rrethanave të çështjes konkrete, pretendimi i kërkuarit për cenimin e parimit të barazisë së armëve është i pabazuar.

C.2. Për pretendimin e cenimit të së drejtës së aksesit në gjykatë

37. Kërkuari ka pretenduar se është cenuar e drejta e aksesit në gjykatë, pasi gjykata e shkallës së parë nuk e ka shqyrtuar çështjen në themel. Po kështu, gjykata e apelit, për shkak të shkeljeve të evidentuara, duhej ta prishte vendimin e gjykatës së shkallës së parë dhe ta dërgonte çështjen për rishqyrtim në po atë gjykatë ose të përsëriste hetimin gjyqësor, gjë që nuk e ka bërë. Edhe Gjykata e Lartë, sipas kërkuarit, nuk i ka korrigjuar këto mangësi, çka e bën vendimin e saj të cenueshëm.

38. Subjekti i interesuar, Ardit Bardhi, ka prapësuar se ky pretendim i kërkuarit është i pabazuar. Sipas tij, kërkuari e ka ushtruar këtë të drejtë duke vënë në lëvizje gjykatën e apelit dhe Gjykatën e Lartë, të cilat u kanë dhënë përgjigje në vendim pretendimeve të ngritura prej tij.

39. Në nenin 42, pika 2, të Kushtetutës parashikohet se kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe interesave të tij kushtetuese dhe ligjore, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj. Kjo dispozitë sanksionon të drejtën për gjykim, ku e drejta e aksesit, që është e drejta për të vënë në lëvizje gjykatën, përbën një aspekt të saj. E drejta e aksesit u garanton subjekteve të cenuara të drejtën t'i drejtohen një gjykate, e cila do t'i dëgjojë pretendimet e tyre dhe do të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik. Gjykata ka vlerësuar vazhdimisht se administrimi i mirë i drejtësisë fillon me garancinë që një individ të ketë akses në gjykatë për t'i siguruar atij të gjitha aspektet e një forme gjyqësore të shqyrtimit të çështjes. Kjo e drejtë e individit nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesit në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal. Në rast se mohohet kjo e drejtë procesi konsiderohet i parregullt, sepse aksesit në gjykatë është, para së gjithash, një kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera të individit. Shteti i

së drejtës nuk mund të konceptohet pa u njohur individëve të drejtën dhe mundësinë për t'iu drejtuar gjykatës (*shtih vendimet nr. 3, datë 23.2.2016; nr. 52, datë 14.11.2014, të Gjykatës Kushtetuese*).

40. Duke iu kthyer çështjes në shqyrtim, rezulton se kërkuari nuk e ka ngritur në rekurs mosrespektimin e parimit të aksesit në gjykim nga gjykatat e faktit. Më konkretisht, në rekurs ai ka parashtruar pretendimet se gjykata e apelit nuk ka marrë parasysh provat që provojnë kontributin e tij më të madh në pronën e përbashkët në krahasim me bashkëpronarët e tjerë, nuk ka zbatuar drejt ligjin material e procedural dhe nuk ka arsyetuar vendimin e saj.

41. Bazuar në rrethanat konkrete të çështjes dhe nga leximi gjithëpërfshirës i vendimeve gjyqësore, Gjykata çmon se kërkuari ka pasur akses në gjykatë, duke marrë pjesë në gjykim dhe duke parashtruar pretendimet e tij nëpërmjet përfaqësuesit ligjor. Gjithashtu, ai ka pasur mundësi të ushtrojë të drejtën e ankimit dhe të rekursit për të kundërshtuar vendimet gjyqësore të gjykatës së shkallës së parë dhe gjykatës së apelit. Fakti që Gjykata e Lartë nuk ka marrë vendim për prishjen e dy vendimeve të gjykatave më të ulëta dhe dërgimin e çështjes për rigjykim, nuk është argument bindës në mbështetje të pretendimit të tij për cenimin e së drejtës së aksesit. Për më tepër, prishja e dy vendimeve dhe dërgimi i çështjes për rigjykim në shkallë të parë nuk është kërkuar prej tij në rekurs. Për pasojë, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuarit për cenimin e së drejtës së aksesit është i pabazuar.

C.3. Për pretendimin e cenimit të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor

42. Kërkuari ka pretenduar se është cenuar standardi i arsyetimit të vendimit gjyqësor nga gjykata e apelit dhe Gjykata e Lartë. Sipas tij, vendimi i gjykatës së apelit është i paargumentuar, i pambështetur në prova shkresore, i paqartë dhe, për rrjedhojë i pambështetur në ligj. Nga ana tjetër, edhe vendimi i Gjykatës së Lartë ka mangësi në drejtim të garantimit të standardit të arsyetimit, për arsye se Gjykata e Lartë nuk i ka dhënë përgjigje pretendimit të kërkuarit në lidhje me cenimin e standardit të arsyetimit nga gjykata e apelit.

43. Subjekti i interesuar, Ardit Bardhi, ka parashtruar se në çështjen konkrete vendimet gjyqësore e plotësojnë standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor jo vetëm nga pikëpamja formale,



por edhe në aspektin substancial. Ndryshe nga sa pretendon kërkuesi, gjykata e apelit dhe Gjykata e Lartë në vendimet e tyre kanë marrë parasysh dhe kanë vlerësuar pretendimet e kërkuesit, u janë referuar dispozitave ligjore për zgjidhjen e çështjes dhe nëpërmjet argumentimit ligjor kanë nxjerrë konkluzionin që përmban dispozitivi i secilit vendim gjyqësor.

44. Lidhur me standardin e arsytimit të vendimit, Gjykata ka theksuar domosdoshmërinë e arsytimit të vendimeve gjyqësore si një garanci për procesin ligjor. Vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Funksioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve se ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimin nr. 18, datë 15.3.2016, të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë drejtim vendimi gjyqësor, në çdo rast, duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre dhe në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht dhe të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie, kontradiksion të hapur ose të fshehtë. Këto argumente duhet të jenë, gjithashtu, të mjaftueshme për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese (*shih vendimet nr. 3, datë 26.1.2015; nr. 63, datë 23.9.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

45. Zbatimi i këtij parimi është vlerësuar nga Gjykata, rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsytimin e vendimeve të tyre (*shih vendimin nr. 18, datë 15.3.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

46. Bazuar në standardet e mësipërme dhe analizën e çështjes në shqyrtim, Gjykata vëren se vendimi i gjykatës së apelit përmban të dhënat e palëve, vendimmarrjen e gjykatës së shkallës së parë, shkaqet e ngritura në ankim, ligjin e zbatueshëm, si dhe pjesën arsyetuese ku gjykata e apelit mbështet qëndrimin e saj të shprehur në dispozitiv. Më konkretisht, ajo, pasi ka marrë

parasysh pretendimet e palëve, ka vlerësuar se vendimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është i bazuar në provat e administruara gjatë gjykimit (*f. 14 e vendimit të gjykatës së apelit*). Gjykata e apelit i ka dhënë përgjigje edhe pretendimit të kërkuesit në lidhje me kontributin e tij më të madh në vënien e pasurisë së përbashkët, duke e çmuar këtë pretendim si të pavërtetuar nga provat e administruara në seancë gjyqësore (*f. 16 e vendimit të gjykatës së apelit*). Për pasojë, vendimi i gjykatës së apelit nuk rezulton të jetë alogjik, kontradiktor ose i paqartë në përmbajtje.

47. Nga ana tjetër, edhe vendimi i Gjykatës së Lartë përmban të dhënat e palëve, vendimmarrjen e gjykatave më të ulëta, pretendimet e ngritura në rekurs, ligjin e zbatueshëm, si dhe pjesën arsyetuese, ku ajo u jep përgjigje pretendimeve të ngritura në rekurs.

48. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se pretendim i kërkuesit për cenimin e standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor është i pabazuar.

49. Si përfundim, nisur nga sa më sipër, Gjykata vlerëson se në rastin konkret pretendimet e kërkuesit për cenimin e parimit të barazisë së armëve, të së drejtës së aksesit në gjykatë dhe të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor janë të pabazuara.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e vijuese të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 1.4.2021.

Shpallur më 27.4.2021.

Kryetare: Vitore Tusha

Anëtarë: Marsida Xhaferllari, Elsa Toska, Altin Binaj, Fiona Papajorgji, Sonila Bejtja, Përparim Kalo.



VENDIM
Nr. 64, datë 27.4.2021

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN E
AUTORITETIT TË MEDIAVE
AUDIOVIZIVE NR. 220, DATË 1.12.2017,
“MBI PËRCAKTIMIN E PAGESAVE PËR
LICENCË/AUTORIZIM DHE
SHËRBIMET QË KRYHEN NGA
AUTORITETI I MEDIAVE
AUDIOVIZIVE”**

Në mbështetje të nenit 19, pika 1, germa “P”, dhe pika 16, si dhe të nenit 25, pika 2, të ligjit nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, Autoriteti i Medive Audiovizive

VENDOSI:

1. Pas pikës 2.9, të kreut II, të vendimit nr. 220, datë 1.12.2017, të AMA-s, shtohet pika 2.10, si më poshtë:

2.10 Masa e pagesës vjetore për autorizim për përdorimin e frekuencave të brezit HF, për ofrimin e shërbimit audio:

lekë

Nr.	Oraret e përdorimit	Masa e pagesës
1	1–8 orë	15,000,000
2	9–16 orë	18,000,000
3	17–24 orë	21,000,000

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Gentian Sala

KËRKESË
Nr. 11/7, datë 28.4.2021

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Për ndërtimin e banesave për strehim social, Roskovec”.

Subjekti kërkuar i këtij projekti është Bashkia Roskovec.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilët do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogarit, bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, sipas tabelës paraprake bashkëlidhur.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 741 000 (shtatëqind e dyzet e një mijë) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
KRYETAR I KOMISIONIT TË POSAÇËM
TË SHPRONËSIMEVE
Erlis Hereni

**LISTA EMËRORE PARAPRAKE E PRONARËVE TË PASURIVE, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA
REALIZIMI I PROJEKTT “PËR NDËRTIMIN E BANESAVE PËR STREHIM SOCIAL, ROSKOVEC”**

Nr.	Emër, atësi, mbiemër	ZK	Nr. i pasurisë	Sip. e prekur truall (m ²)	Çmimi për truall (lekë/ m ²)	Vlera e truallit	Sip. e ndërtes ës së prekur	Çmimi i ndërtesës lekë/m ²	Vlera e ndërt esës	Vlera totale	Shënime squares
1	Bashkëpronarët: Ilirjan Kongoli, Hajrie Shehu, Ymid Resuli, Mehdi Hoxha, Egerem Risilia, Kujtim Kryeziu, Xheladin Kryeziu, Pranvera Kryeziu, Muharrem Resuli, Et'hem Resuli, Senije Resuli, Umberto Resuli, Rubie Risilia, Jolldiz Bedini	3196	3/294	1500	494	741000	0	30000	0	741000	Konfirmuar nga ASHK Drejtoria Vendore Fier
Shuma	Vlera totale paraprake			1500		741000	0		0	741000	

**KËRKESE****Nr. 113/2, datë 29.4.2021****PËR SHPRONËSIM PUBLIK**

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Ndërtimi i godinës qendrore administrative të shërbimeve të qëndëruara të transportit rrugor shqiptar dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor”.

Subjekti kërkuar i këtij projekti është Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilët do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur, bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, sipas tabelës paraprake bashkëlidhur.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është **26 904 342 (njëzet e gjashtë milionë e nëntëqind e katër mijë e treqind e dyzet e dy) lekë**.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
KRYETAR I KOMISIONIT TË
POSAÇËM TË SHPRONËSIMEVE
Erlis Hereni

**LISTA EMËRORE PARAPRAKE E PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME,
PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA PROJEKTI “NDËRTIMI I GODINËS
ADMINISTRATIVE TË DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË SHËRBIMEVE TË
TRANSPORTIT RRUGOR, BASHKIA TIRANË”**

Nr.	Emër	Atësi	Mbiemër	Lloji i pasurisë	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Sip. totale (m ²)	Sip. e prekur (m ²)	Çmimi truall lekë/m ²	Sip. obj. e prekur (m ²)	Çmimi obj.lekë/m ²	Vlera në lekë	Shënime në kartelë
1	Arben Besim Dashmir Fatbardha Fatmir Fatmira Hasan Hatixhe Hatixhe Haxhi Haxhire Ilirjan Jemine Mimoza Myzejen Nazim Nuri Paqize Pranvera Shpresa Shqiponja Suzana Ylvis	Sadik Hamdi Muhamet Muhamet Alla Sadik Haxhi Eqerem Ruka Vathi Muhamet Eqerem Muhamet Sadik Hamdi Eqerem Muhamet Eqerem Ruka Pinari	Vathi Ruka Tutaj Vathi Ruka Çausi Ruka Vathi Çausi Ruka Banubi Ruka Vathi Ruka Kulluku Spartaku Ruka Osmanliu Ruka	truall	8250	1/10	3080	874	30783			26,904,342	Në bazë të vendimit nr. 12259, datë 22.12.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë njihet Lura Lera trashëgimtare e Hasan Haxhi Ruka në 1/16 pjesë. -Me referencën 14198, vendim gjykatë të apelit 3232, datë 26.9.201 njihet si trashëgimtare e Hasan Ruka dhe Jondia Vrapit me 1/16 pjesë. Ka ndërtim pa leje
2	Shtet			shesh	8250	1/1006	658	658	30783			0	Mbi këtë truall ndodhet objekti nr. 1/926-ND VOL30, FQ.183
3	Shtet			shesh	8250	1/1007	318.39	318.39	30783			0	Mbi këtë truall ndodhet objekti nr. 1/926-ND VOL30, FQ.184
4	Shtet (Republika e Shqipërisë)			ndërtesë	8250	1/926-ND	429	429	30783			0	VKM nr. 226, datë 23.4.2004 nën administrimin e Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturs, DPSHTRR
Vlera totale e shpronësimit												26,904,342	

1. Për tokën truall, çmimi i llogaritur është marrë nga VKM-ja nr. 89, datë 3.2.2016.

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2021

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 80 lekë